

FTESË

Konventa Kombëtare për Integrimin European 2021-2023

Grupi i Punës I (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore) Sesioni 2, Tema: E Drejta e Pronës në kuadër të Kapitullit 23

22 dhjetor 2022, 16:30- 17:45
Online në Platformën Zoom

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) dhe Slovak Foreign Policy Association (SFPA) në bashkëpunim me Shkollën e Avokatisë në Shqipëri, me mbështetjen financiare të SlovakAid, kanë kënaqësinë t'iu ftojme në sesionin 2 të Grupit të Punës I fokusuar në "E drejta e pronës në kuadër të Kapitullit 23" që po organizohet në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin European 2021- 2023.

Konventa fokusohet në 3 drejtime kryesore: 1) rritja e pjesëmarrjes së të gjithë segmenteve të shoqërisë shqiptare (përfshirë edhe nivelin lokal); 2) institucionalizimi i debatit publik në çështjet e BE-së bazuar në bashkëpunimin e institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe ato të biznesit; dhe 3) forcimi i kapaciteteve në negociatat për integrimin në BE përmes transferimit të njohurive sllovaqe.

Në sajë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me ministritë dhe agjencitë kyçe gjatë periudhës 2014-2021 si Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, janë krijuar disa grupe pune për të adresuar kapitujt më sfidues të negociatave të Acquis së BE-së. Gjatë Konventës 2021–2023 po organizohen 16 sesione për katër Grupe Pune, më konkretisht: GP I – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore (Kapitulli 23); GP II – Drejtësia, Liria, Siguria (Kapitulli 24); GP III – Bujqësia dhe Mbrojtja e Konsumatorit (Kapitulli 11, 12 dhe 28); GP V – Çështjet e Tregtisë dhe Ekonomisë (Kapitulli 1, 2, 3, 4 dhe 20).

Grupi i Punës I, falë eksperiencës së ekspertëve, po shqyrton dhe diskuton tema në fushën e të drejtave themelore, luftës ndaj korrupsionit, reformës në drejtësi dhe procesit screening për Kapitullin 23. Më shumë se 10 sesione janë organizuar për këtë Grup Pune gjatë Konventës, ndërkohë që për periudhën 2021-2023 janë parashikuar të zhvillohen **katër sesione**. Këto sesione bashkëdrejtohen nga përfaqësues të institucioneve shtetërore, institute akademike, shoqëria civile dhe ekspertë të brendshëm të Konventës.

Aktivitetin online mund ta ndiqni në Platformën Zoom:

Zoom Link:

<https://us06web.zoom.us/j/88582412349?pwd=eGREekRsRy9WcmowK0ovamxudFJjUT09>

Meeting ID: 885 8241 2349

Passcode: NCEI-AL

Ju lutemi konfirmoni pjesëmarrjen në: info@em-al.org.

**Gjatë aktivitetit do të ofrohet përkthim i njëkohshëm i gjuhës angleze*

PROGRAMI

Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

Grupi i Punës I (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore)

Sesioni 2, Tema: E Drejta e Pronës në kuadër të Kapitullit 23

22 dhjetor 2022, 16:30- 17:45

Online në Platformën Zoom

16:15 – 16:30 Regjistrimi i pjesëmarrësve

16:30 – 16:35 Hapja e aktivitetit

Gledis Gjipali, Drejtori Ekzekutiv, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

16:35 – 17:00 E drejta private evropiane: Prona & Trashigimia

Prof. Asoc. Denard Veshi, Lektor, Kolegji Universitar Bedër, Shqipëri

- E Drejta Europiane e Pronës (p.sh. Dir. 1346/2000/KE & Reg. 2015/848; Dir. 2014/60/BE; dhe Dir. 2008/122/KE)

- E Drejta Europiane e Trashëgimisë (Reg. 2012/650)

- Ndikimi i procesit të integritimit Europian në të drejtën private shqiptare

17:00 – 17:30 Mbrojtja e të drejtave të pronës në Sllovakia – zhvillimet kryesore mbi çështjen

Andrej Leontiev dhe Kristína Kesnerova, Firma Ligjore Taylor Wessing dega në Bratislavë

- E drejta e pronës në Sllovakia – çfarë mund të mësojmë nga rasti sllovak?

- Raste praktike dhe zhvillime pozitive në kuadër të mbrojtjes së pronës – regjistri i përfituesve dhe i kontratave publike, regjistri i kredive dhe regjistri i kompanive

- Parimet bazë të kadastrave të pronës në Sllovakia – e drejta e pronës si e drejtë themelore

- Publikimi dhe transparenca për pronësinë –element i rëndësishëm për të luftuar asimetritë e informacionit, por dhe sfidues në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale

17:30 – 17:45 Diskutim i hapur me pjesëmarrësit